



**NJOFTIM**  
**PËR**  
**FILLIMIN E PROCESIT TË TRAJNIMIT TË VIJUESHËM PROFESIONAL TË**  
**AUDITUESVE TË BRENDSHËM NË DETYRË NË SEKTORIN PUBLIK PËR VITIN**  
**2023**

1. Në zbatim të urdhrorit nr.295, datë 30.12.2022, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “Për miratimin e Programit të Trajnimit të Vijueshëm Profesional për Audituesit e Brendshëm në sektorin publik për vitin 2023”, Drejtoria e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm njofton fillimin e procesit të trajnimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, si dhe hapjen e procedurës së aplikimeve të kandidatëve për trajner në këtë proces.
  2. Të gjithë individët të cilët janë të interesuar për të aplikuar për trajnerë, duhet të plotësojnë kriteret e kualifikimit të përcaktuara në rregulloren e trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm në sektorin publik, sa më poshtë:
    - a) Të kenë të paktën diplomë “Master i shkencave” ose “Master i Arteve”, si dhe eksperiencë në profesion, sipas përcaktimeve në VKM nr.116, datë 17.02.2016 “Për mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përbërjen e Komisionit të Kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në sektorin publik dhe përcaktimin e tarifave të trajnimit”;
    - b) Të kenë të paktën 2 vite eksperiencë në mësimdhënie;
    - c) Të kenë integritet moral dhe profesional;
    - d) Të kenë aftësi të shkëlqyera komunikimi dhe prezantimi;
    - e) Të kenë aftësi për të hartuar dhe prezantuar temën sipas programit;
  3. Çdo kandidat që aplikon për trajner duhet të paraqesë zyrtarisht brenda 2 (dy) javëve nga data e publikimit të këtij njoftimi dokumentacionin e mëposhtëm:
    - a) Kërkesë;
    - b) Curriculum Vitae;
    - c) Fotokopje të noterizuar të diplomës universitare dhe certifikata të kualifikimeve profesionale;
    - d) Vërtetim të eksperiencës në profesion;
    - e) Vërtetim të eksperiencës në mësimdhënie;
  4. Dokumentacioni i kërkuar duhet të dorëzohet zyrtarisht në protokollin e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.
- Afati i pranimit të dokumentacionit fillon në datën **18.01.2023** dhe përfundon në datën **01.02.2023**.

Detaje më të hollësishme lidhur me procedurën e përzgjedhjes së trajnerëve dhe temat e parashikuara në Programin e trajnimit të vijueshëm profesional të audituesve të brendshëm për vitin 2023, i gjeni në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me adresë: [www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al).